



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR**  
**TIRANË**

**Nr.26 Regj.Them.**  
**Datë Rregj.02.06.2023**

**Nr. 26 VENDIMI**  
**Datë 07.06.2023**

**V E N D I M**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

<b>Gjyqtare:</b>	<b>Manjola XHAXHO</b> (Relatore)
<b>Gjyqtar:</b>	<b>Sokol IBI</b> (Anëtar)
<b>Gjyqtare:</b>	<b>Edlira PETRI</b> (Anëtare)
<b>Gjyqtare:</b>	<b>Blerona HASA</b> (Anëtare)
<b>Gjyqtare:</b>	<b>Alma KOLGJOKA</b> (Anëtare)

asistuar nga sekretare gjyqësore Ermelinda Nuraj, më datë 07.06.2023, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr. 26 regj., them., datë 02.06.2023 që i përket palëve:

**PADITËS:** **Z. Lefter Maliqi**, i biri i Novrus dhe Esmë, lindur më 10.02.1972 në Berat dhe banues në Kuçovë, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga av. Arben Llangozi dhe av. Orgesa Serani me prokurë të posaçme nr.rep.1411, nr.kol. 776, datë 21.05.2023.  
**Koalicioni “Bashkë Fitojmë”**, përfaqësuar nga av. Altin Kaziaj sipas autorizim nr. 493/1 prot, datë 05.06.2023.

**IPADITUR:** **Komisioni Qendror Zgjedhor** (Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve), përfaqësuar nga juristja znj. Ina Osmanaj, sipas autorizimit nr. 5790 prot. ,datë 02.06.2023.

**PERSON I TRETË:** **Partia Socialiste e Shqipërisë**, me seli në Tiranë, Sheshi “Austria”, Nr.91, përfaqësuar nga av.Maringlen Legisi, sipas autorizimit nr.277 Prot. date 25.05.2023.

**OBJEKTI:** Shfuqizimin e pikës 2 të vendimit me nr.136 datë 24.05.2023, të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) duke vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për gjykim pamë KAS.

**BAZA LIGJORE:** Neni 124 e vijues i Kodit Zgjedhor; nenet 4, 13, 14, 23, 24, 90, 109, 116 të Kodit të Proedurave Administrative.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Kolegji Zgjedhor, pasi dëgjoi palët paditëse që kërkuan pranimin e padisë, sipas objektit, palën e paditur që kërkoi rrëzimin e padisë, personin e tretë Partia Socialiste e Shqipërisë që kërkoi rrëzimin e padisë, si dhe analizoi provat dhe ligjin;

### **VËREN:**

1. Paditësi, z. Lefter Maliqi i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor me padinë me objekt “*Shfuqizimin e pikës 2 të vendimit me nr. 136 datë 24.05.2023, të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) duke vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për gjykim pamë KAS*”. Kjo çështje është regjistruar me nr. 26 regj. them., datë 02.06.2023. Ndërsa pala paditëse Koalicioni “Bashkë Fitojmë” i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor, me kërkesë për ndërhyrje kryesore dhe ka depozituar padinë me objekt “*Shfuqizimin e pikës 2 të vendimit me nr. 136 datë 24.05.2023, të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) duke vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për gjykim pamë KAS*”. Padia është regjistruar me nr. 28 regj., them., datë 05.06.2023.

2. Në seancë gjyqësore Koalicioni “Bashkë Fitojmë” kërkoi bashkimin e çështjeve të mësipërme. Kolegji Zgjedhor më datë 06.05.2023 pasi dëgjoi palët e tjera ndëgjyqëse (paditëse dhe të paditur që u shprehën dakord) vendosi të bashkojë çështjet e mësipërme sipas nenit 57, pika 3 të KPrC duke vijuar gjykimi me dy palët paditëse sipas objektit të padisë. Po ashtu Kolegji Zgjedhor kryesisht në kuptim të nenit 193 të KPrC vendosi të thërrasë me cilësinë e palës së tretë subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, e cila ka qenë palën e interesuar në procesin administrativ të zhvilluar nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS).

### **Rrethanat e çështjes**

3. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datë e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. Paditësi z. Lefter Maliqi është regjistruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me koalicionin “Bashkë

Fitojmë”<sup>1</sup> për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, duke kandiduar për kryetar të Bashkisë Kuçovë.

4. Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor (KZAZ) nr. 64, Bashkia Kuçovë, Qarku Berat si organ i administratës zgjedhore kompetent për miratimin e rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë ka vendosur me vendimin nr. 101, datë 16.06.2023 "Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për Zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë". Bashkëngjitur këtij vendimi është shpallur fitues z. Kreshnik Riza Hajdari, kandidati për kryetar i Bashkisë Kuçovë, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

5. Pala paditëse z. Lefter Maliqi, duke mos qenë dakord me vendimin nr. 101 datë 16.06.2023 të KZAZ-së nr. 64, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023 i është drejtuar më datë 21.05.2023 KAS, më kërkesë ankimore që është regjistruar me nr. 74 regj., datë 22.05.2023. Kjo kërkesë ankimore ka si objekt:

1. Ndryshimi i Vendimit Nr. 101 datë 16.06.2023 të ZAZ-së Nr. 64 Bashkia Kuçovë, Qarku Berat, "Për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për Zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë".

2. Rinumërim dhe rivlerësim i votave për ZAZ-në Nr. 64, të gjitha QV-të duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për QV-të e listuara në tabelë.

3. Pavlefshmëria e vendimit nr. 101 datë 16.05.2023, "Për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për Zgjedhjen e Kryetarit të bashkisë Kuçovë".

4. Konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit të KQZ ku është emëruar sekretari i KZAZ, Nr.64 Kuçovë, shtetasi Romeo Arizi.

5. Pavlefshmërinë e vendimit të KZAZ, Nr.64 Kuçovë, Qarku Berat, për shtyrjen e numërimit të votës, nga ora 11:00 deri në 12:30.

6. Pavlefshmërinë e pjeshme të fletës së votimit Kandidatët për Kryetar Bashki për Bashkinë Kuçovë, në pikën ku është shënuar kandidati për Bashkinë Kuçovë Qarku Berat Kreshnik Hajdari.

7. Pavlefshmërinë e veprimit juridik, formularin e dekriminalizimit, në emër të Kreshnik Hajdarit dorëzuar pranë K.Q.Z referuar ligjit, nr. 138/2015 "Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

6. KAS, pasi shqyrtoi ankesën e z. Lefter Maliqi, në datë 24.05.2023, bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja "a" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash, vendosi:

---

<sup>1</sup>Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 178, datë 18.03.2023 "Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit "Bashkë Fitojmë", (BF), përzgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023", pasi mori në shqyrtim dokumentacionin ka vendosur: 1.Regjistrimin e Koalicionit "BASHKËFITOJMË" (PL-PDK-PBDNJ), "BF", si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, me parti pjesëtare tëtij si më poshtë:a) "Partia e Lirisë" (PL);b) "Partia Demokratiane e Shqipërisë" (PDK);c) "Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut" (PBDNJ)

“- Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 74, datë 22.05.2023, të paraqitur nga z. Lefter Maliqi, me objekt ndryshimin e vendimit nr. 101, datë 16.05.2023 të KZAZ nr. 64, bashkia Kuçovë.

2. Rrëzimin për mungesë kompetence për kërkesat e tjera të paraqitur në kërkesë ankimore.

3. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 26.05.2023, ora 11:30.

4. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative”.

7. Referuar vendimit të marrë nga KAS rezulton ndër të tjera se :

“... Në mbledhjen e datës 24.05.2023, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 74 i plotësonte elementet e formës të parashikuara në nenin 126 dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.”

8. Referuar procesverbalit në seancën dëgjimore të zhvilluar në KAS më datë 24.05.2023, ku është marrë në shqyrtim kërkesa ankimore e mësipërme nr. 74 rezulton se pasi janë dëgjuar palët KAS ka vendosur: pranimin e kërkesës për ndryshimin e vendimit nr. 101, datë 16.06.2012; pranimin e kërkesës për pavlefshmëri të zgjedhjeve në zonën zgjedhore të Bashkia Kuçovë dhe rrëzimin për mungesë kompetence të kërkesave të tjera.

9. Më datë 20.05.2023, pala paditëse Koalicioni “Bashkë Fitojmë” rezulton t’i jetë drejtuar me kërkesë ankimore KAS, për ndryshimin e vendimit nr. 101, datë 16.06.2023 të KZAZ-së nr. 64, Bashkia Kuçovë, Qarku Berat, "Për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për Zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë", e cila është regjistruar me nr. 69 regj, datë 22.05.2023.

10. KAS në lidhje me ankesën e palës ankuese Koalicioni “Bashkë Fitojmë, në mbledhjen e datës 26.05.2023, konstatoi se kërkesa ankimore i plotësonte elementet e formës të parashikuara në nenin 126 dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Në këto kushte KAS me vendimin nr. 151, datë 26.05.2023 vendosi:

“-Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 67, datë 20.05.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

- Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 01.06.2023, ora 13:30.

- Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve dhe me zbatimin e tij.

- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative”.

11. KAS me vendimin e ndërmjetëm nr. 152, datë 26.05.2023 vendosi :

- Shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 67, datë 20.05.2023 dhe nr. 74, datë 22.05.2023.

- Shqyrtimi do të bëhet në datën 01.06.2023 ora 13:30.

- Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve në mungesë dhe me zbatimin e tij.

-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

12. Më datë 29.05.2023 pala paditëse, subjekti zgjedhor, z. Lefter Maliqi, kandidat për kryetar bashkie i Bashkisë Kuçovë, ka paraqitur padinë objekt gjykimi brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 152 pika 2 e Kodit Zgjedhor që parashikon ndër të tjera se ankimi për të gjitha vendimet që KQZ-ja merr në periudhën, e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme ose të përgjithshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e tyre. Kësaj padie iu bashkuar me cilësinë e bashkëpaditësit, subjekti zgjedhor, Koalicioni “Bashkë Fitojmë” përfaqësues i të cilit është kandidati z. Lefter Maliqi. Sipas paditësve vendimi nr. 136, datë 24.05.2023 në lidhje me rrëzimin për mungesë kompetence të kërkesave të tjera të paraqitur në kërkesë ankimore nr. 74 të paraqitur nga z. Lefter Maliqi është pjesërisht absolutisht i pabazuar në prova dhe ligj. Sipas paditësve kërkesat ankimore që janë rrëzuar janë pikërisht: “ 4. Konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit të KQZ ku është emëruar sekretari i KZAZ, Nr.64 Kuçovë, shtetasi Romeo Arizi. 5. Pavlefshmërinë e vendimit të KZAZ, Nr.64 Kuçovë, Qarku Berat, për shtyrjen e numërimit të votës, nga ora 11:00 deri në 12:30. 6. Pavlefshmërinë e pjesshme të fletës së votimit Kandidatët për Kryetar Bashki për Bashkinë Kuçovë, në pikën ku është shënuar kandidati për Bashkinë Kuçovë Qarku Berat Kreshnik Hajdari. 7. Pavlefshmërinë e veprimit juridik, formularin e dekriminalizimit, në emër të Kreshnik Hajdarit dorëzuar pranë K.Q.Z referuar ligjit, nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

13. Në gjykim paditësi z. Lefter Maliqi sqaroi se kërkimet në kërkesën ankimore kanë lidhje me kërkimin e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në zonën zgjedhore dhe se nuk janë kërkime të mëvetësuar. Më tej pretendimet e palëve paditëse në mënyrë të përmbledhur të parashtruara në padi dhe në seancë gjyqësore janë si më poshtë:

- KAS në dhënien e vendimin nr. 136 datë 24.05.2023 ka vepruar në kundërshtim me Kodin Procedurave Administrative (KPrA) dhe konkretisht: i) me nenin 4 që parashikon se organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe

legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca; si dhe të drejtat apo interesat e ligjshme të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor.; ii) me nenin 13 që parashikon se organet publike duhet të ushtrojnë detyrën e tyre në përputhje me drejtësinë (ligjin) dhe njëkohësisht të jenë të paanshëm. Konkretisht në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie.;iii) me nenin 14 që përcakton qartë se gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative.; iv) me nenin 16 që parashikon se një organ publik merr vendime për të gjitha çështjet e ngritura nga një palë, të cilat janë në kompetencë të tij.

- Sipas palëve paditëse KAS pas verifikimeve se nuk është kompetente ka vendosur rrëzimin e kërtimeve. Ky vendim është i pabazuar në ligj dhe haptazi në kundërshtim me nenin 24 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon në mënyrë të qartë se 1. Kur një organ publik merr një kërkesë, për një çështje që e vlerëson jashtë kompetencës të vet, ia përcjell kërkesën menjëherë, dhe në çdo rast jo më vonë se dy ditë nga marrja e saj, organit publik kompetent dhe njofton kërkuesin për këtë.
- Sipas paditësve KAS me vendimin të ndërmjetëm, objekt gjykimi ka vendosur rrëzimin e kërkesave duke zgjidhur përfundimisht çështjen në lidhje me kërkimet e tij pa respektuar nenin 90 të Kodit të Procedurave Administrative që parashikon se 1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, përfundon me një vendimmarrje përfundimtare për çështjen, përkatësisht një akt administrativ apo një kontratë administrative. Në vendimin përfundimtar për çështjen, organi publik vendos për të gjitha çështjet e ngritura nga palët gjatë procedurës dhe që nuk kanë marrë zgjidhje gjatë tij. 2. Përfundimi i procedurës administrative, të nisur kryesisht, është në diskrecion të organit publik, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji. 3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ. Sipas palëve të paditura vendimi i KAS nuk është i arsyetuar dhe kopja që u është dhënë atyre nuk është nënshkruar nga të katër anëtarët dhe për pasojë është i pavlefshëm. Sipas palës paditëse pavlefshmëria absolutet pretendohet në çdo kohë apo merret në shqyrtim kryesisht nga organi administrativ apo gjyqësor.
- Sipas palëve paditëse vendimi i KAS është i paligjshëm sipas nenit 109 Kodit të Procedurave Administrative dhe në kuptim të nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative duhet të shfuqizohet dhe çështja duhet të kthehet në KAS që të marrë vendim në lidhje me këto kërtime.

14. Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në gjykim pretendoi se:

- Kodi Zgjedhor përcakton se procedura e shqyrtimit të ankesave në KAS kalon domosdoshmërisht në dy faza, në fazën e verifikimit paraprak dhe në fazën e shqyrtimit në themel. Në fazën e verifikimit paraprak KAS-i shqyrton kompetencën e KQZ-së për shqyrtimin e ankimi, legjitimitimin e ankuesit dhe respektimin e afateve ligjore për ankimin (neni 130 Kodit Zgjedhor). KAS mund të shqyrtojë vetëm çështje që i përkasin kompetencës së tij të ngritura nga palë që kanë një interes të ligjshëm dhe kur ato janë depozituar brenda afatit ligjor përkatës. Verifikimi paraprak përmbillet me vendimin për kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore, ose me vendimin për moskalimin për shqyrtim të saj. Vendimi i parë është vendim i ndërmjetëm. Ai cakton datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes në themel, ka fuqi deri në këtë datë dhe orë dhe është i pa ankimueshëm. Vendimi i dytë është përfundimtar, për pasojë, i ankimueshëm. Vendimi i KAS-it nr. 136, datë 24.05.2023 ka rënë nga fuqia në datën 26.05.2023, pasi nuk është i ankimueshëm pasi ka kaluar çështjen për shqyrtim në seancë. Në praktikën e KAS, vendimet e ndërmjetme arsyetohen bashkë me vendimin përfundimtar, për shkak se ankimohen bashkë me të. KAS-i nuk është shprehur ende me vendimin përfundimtar për arsyetimin ligjor për mospranimin e pikave të objektit të kërkesës ankimore. Pavarësisht kësaj arsyetimi për rrëzimin e këtyre pikave të kërkesës ankimore është shpjegim i thjeshtë i kuadrit ligjor.
- Sipas palës së paditur KAS ka kompetencë shqyrtimin e ankimeve administrative ndaj vendimeve të KZAZ-ve dhe ndaj vendimeve të Komisionerit (pika 5 e nenit 12, pika 1 e nenit 21 të Kodit Zgjedhor), ndërkohë që subjektet zgjedhore gëzojnë të drejtën e posaçme të ankimit në KAS kundër vendimit të KZAZ-së ose të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultatit për zgjedhjet e organeve të njëjësive të qeverisjes vendore të juridiksionit të tyre (pikat 2 dhe 3, të nenit 124 të Kodit Zgjedhor). Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi. Duke shfrytëzuar këtë bazë ligjore (nenin 124), ankuesi ka vënë në lëvizje KAS-in me kërkesën ankimore nr. 74. Në përputhje me nenin 124, ankuesi ka kërkuar "ndryshimin e vendimit nr. 101, datë 16.06.2023 të KZAZ-së nr. 64, bashkia Kuçovë, qarku Berat "Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Kuçovë", por jo pavlefshmërinë e rezultatit në një ose disa qendra votimi. Kërkesa për "pavlefshmërinë e vendimit nr. 101, datë 16.05.2023 "Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Kuçovë" (pika 3 e objektit të kërkesës ankimore), e cila bie në kundërshtim dhe është e papajtueshme me pikën 1 të njëjtë objekt, me kërkesën për "ndryshimin e vendimit nr. 101, datë 16.06.2023 të ZAZ- së nr. 64" u konsiderua lapsus nga ankuesi, i cili dha sqarimin se qëllimi ishte të kërkohej pavlefshmëri rezultati. KAS-i orientoi ankuesin drejt saktësimit të kësaj kërkesë, sepse për të njëjtën QV nuk mund të kërkohej dhe ndryshim i rezultatit dhe pavlefshmëri e tij. Kërkesat nuk mund të jenë konkurruese me njëra tjetrën. Ato janë alternativa të njëra tjetrës.
- Sipas palës së paditur kërkesa ankimore për konstatimin e vendimit nr. 163, datë 10.03.2023 "Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të komisioneve të zonave të

- administrimit zgjedhor, të propozuar nga koalicioni "Bashkë Fitojmë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023" (pika 4 e objektit të kërkesës ankimore), me të cilin është emëruar në detyrë sekretari i KZAZ-së nr.64, z. Romeo Harizi, organi publik që ka nxjerrë aktin është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Për pasojë sipas palës së paditur kompetente për shqyrtimin e ankesës është Komisioneri.
- Në lidhje me kërkimin për pavlefshmërinë e vendimit të KZAZ-së nr. 64 Kuçovë, qarku Berat, referuar pa numër dhe pa datë nga ankuesi (pika 5 e objektit të kërkesës ankimore), me të cilin është vendosur shtyrja e numërimit të votës, nga ora 10:00 deri në orën 12:30, organi që ka nxjerrë aktin është, sikurse referohet, vetë KZAZ-ja. Për pasojë sipas palës së paditur kompetente për shqyrtimin e ankesës është kjo KZAZ.
  - Në lidhje me kërkimin për pavlefshmëri të vendimit nr. 363, datë 15.04.2023 "Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie në 60 bashki, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023" (pika 6 e objektit të kërkesës ankimore), me të cilin është miratuar fleta e votimit për kandidatët për kryetar bashkie për bashkinë Kuçovë, organi që ka nxjerrë aktin është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Për pasojë sipas palës së paditur kompetente për shqyrtimin e ankesës është Komisioneri.
  - Pra, sipas palës së paditur për të gjitha këto akte, neni 110 i K.Pr.Administrative përcakton kompetencën e organit publik që ka nxjerrë aktin administrativ për shqyrtimin e kërkesave për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të këtyre akteve. Sipas palës së paditur, KZAZ-së nr. 64, si çdo komision tjetër zgjedhor, është trupë e posaçme, e cila ngrihet dhe funksionon sipas rregullave specifike, me kohë të pjesshme dhe me kompozim politik. Anëtarët e komisioneve janë zyrtarë zgjedhorë, por jo zyrtarë shtetërorë. Ata nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil, por emërohen në detyrë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Për shkakun se Komisioneri është organi i emërtesës, ai mund të quhet organi epror i tyre, në kuptimin e dispozitës së nenit 110 të K.Pr.Administrative. Kjo do të thotë se, nëse ankuesi kërkon të vejë në lëvizje organin epror për të kërkuar pavlefshmërinë e akteve të KZAZ-së nr. 64, atëherë organin epror do ta gjejë tek Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Komisioneri, nga ana e tij është organ drejtues i KQZ-së (pika 2 e nenit 12 të Kodit Zgjedhor), organ drejtues i një institucioni të pavarur. Komisioneri nuk ka organ epror, në kuptimin e nenit 110 të KPrA.
  - Sipas palës së paditur KAS-i është "organ kompetent për shqyrtimin e mjeteve ligjore administrative", në kuptimin e nenit 110. Vendimet e KZAZ-ve dhe të Komisionerit ankohen në KAS, brenda afateve të përcaktuara në Kod. Nga dalja e dekretit të Presidentit të Republikës për shpalljen e zgjedhjeve të datës 14 maj 2023 afati i ankimit në KAS ndaj akteve të KZAZ-ve dhe të Komisionerit është 3 ditë (ndaj vendimit për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve, 5 ditë). Afati i ankimit në KAS për pikën 3 të objektit të kërkesës ankimore, afati i ankimit ka mbaruar në datën 21.05.2023, për pikën 4 ka mbaruar në datë 13.03.2023, për pikën 5 ka mbaruar në harkun e tre ditëve nga data e marrjes së vendimit dhe për pikën 6 ka mbaruar në datën 18.04.2023. E drejta e ankuesit për të vënë në lëvizje KAS-in me ankime për këto akte administrative ka rënë në



- dekadencë. Afatet janë ezauruar dhe kërkesa për pavlefshmërinë e akteve nuk mund të parashtrahet në rrugën e ankimimit administrativ.
- Në lidhje me pikën 7 të kërkesës ankimore, sipas palës së paditur, nga përmbajtja duket se është lëndë që i përket të drejtës penale dhe kompetencës lëndore të organeve të ndjekjes penale. Terminologjia e zgjedhur nga ana e ankuesit i përket fushës së të drejtës civile (veprim juridik, etj). E drejta administrative që është fusha ku vepron KAS, njeh konceptin e pavlefshmërisë së akteve administrative. "Formulari i dekriminalizimit" që përmendet në këtë pikë nuk është akt administrativ dhe nuk nxirret nga ndonjë organ publik. Ai është dokument që plotësohet nga individët, nën përgjegjësinë e tyre personale dhe penale. Sipas palës së paditur pika 7 e objektit të kërkesës ankimore nuk përfshihet dot brenda kompetencës së KAS-it.
  - Pala e paditur parashtrroi se legjislatori ka parashikuar në mënyrë eksplicite shterimin e mjeteve ligjore administrative si kusht për ngritjen e padisë në gjykatë. Neni 129 i KPrA parashikon se: "Shterimi i ankimit administrativ, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative". Të ndodhur në kushtet që për këtë çështje gjyqësore vijon ende shqyrtimi administrativ pranë KAS, palët paditëse nuk kanë shteruar mjetet ligjore administrative dhe për pasojë duhet të rrëzohen kërkesë paditë objekt gjykimisi të pabazuar në ligj të paraqitur nga paditësi, "Lefter Maliqi" dhe Koalicioni "Bashkë Fitojmë".

15. Pala e tretë, Partia Socialiste e Shqipërisë kërkoi rrëzimin padisë, pasi pala paditëse z. Lefter Maliqi që ka vënë në lëvizje gjykatën nuk ka të drejtë të ankimonte rezultatin e zgjedhjeve në KAS dhe më pas të paraqiste padinë në Kolegj Zgjedhor, në kuptim të nenit 124 të Kodit Zgjedhor. Kjo pasi ankimi duhet të bëhet nga koalicioni ose partia politike që ka propozuar kandidatin dhe jo nga ky i fundit.

## **II. Vlerësimi i Kolegjit Zgjedhor:**

16. Kolegji Zgjedhor fillimisht vë në dukje se palët paditëse kanë interes ligjor dhe legjitimohen të paraqesin ankim në KAS dhe më tej padi në Kolegjin Zgjedhor. Konkretisht si paditësi z.Lefter Maliqi, me cilësinë e kandidatit për kryetar bashkie në Bashkinë Kuçovë, ashtu edhe koalicioni "Bashkë Fitojmë" që ka propozuar kandidatin e mësipërm janë subjekte zgjedhore në kuptim të nenit 2, pika 20 të Kodit Zgjedhor që parashikon se "Subjekte zgjedhore" janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod. Si të tillë palët paditëse kanë të drejtë t'i drejtohen Kolegjit Zgjedhor për të kundërshtuar vendim-marrjet e KAS (organ i KQZ- së), ndaj të cilave kanë pretendime se cenojnë interesat e tyre në bazë të nenit 145, pika 1 e Kodit Zgjedhor që përcakton se subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të tilla vendim-marrje janë dhe ato të marra nga KAS në kuadër të ankesave të subjekteve zgjedhore të parashikuara në nenin 124 të Kodit Zgjedhor. Pra, pavarësisht se nenit 124 pika 1 e Kodit Zgjedhor parashikon se: Çdo parti politike, pjesëtare

ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit, pra nuk përmenden si subjekte zgjedhore -kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendor- kjo dispozitë ligjore që parashikon të drejtën e subjekteve zgjedhore për të ushtruar ankim pranë KQZ (pra, KAS), duhet interpretuar e lidhur me të drejtën e subjekteve zgjedhore për të ushtruar ankim kundër këtyre vendimeve të KAS, në Kolegjin Zgjedhor sipas nenit 145 të Kodit Zgjedhor. Në këtë kuptim subjektet zgjedhore kanë të drejtën e ankimit fillimisht në KQZ (dmth në KAS) dhe më pas në Kolegj Zgjedhor kur pretendohet se vendimet e KQZ-së cenojnë interesat e tyre. Një qëndrim ndryshe do të bënte të pazbatueshëm nenin 145 të Kodit Zgjedhor në lidhje me subjektet zgjedhor, kandidatë për kryetar bashkie, pasi duke mos i legjitimuar në të drejtën për ankim në KAS sipas nenit 124 të Kodit Zgjedhor, atëherë për këto subjekte zgjedhore nuk do të ekzistonte mundësia për të bërë ankim në Kolegj Zgjedhor, kundër rasteve që pretendojnë se vendim-marrja KAS në lidhje me rezultatin e zgjedhjeve cenon interesat e tyre. Kjo do të çonte për pasojë në cenim të parimit të procesit të rregullt ligjor dhe aksesit në gjykatë parashikuar nga neni 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, neni 43 i Kushtetutës dhe neni 2 i të KPrC. Pra, në kundërshtim me pretendimet e personit i tretë, KAS me të drejtë ka legjitimuar z. Lefter Maliqi në paraqitjen e kërkesës ankimore dhe për pasojë më tej paditësi ka të drejtë të paraqesë padinë objekt gjykimi duke kundërshtuar pjesërisht vendim-marrjen e KAS në rastin konkret objekt gjykimi.

17. Në lidhje me themelin e pretendimeve në padi, Kolegji Zgjedhor thekson se nga provat e administruara në gjykim dhe debati gjyqësor rezultoi se KAS ka marrë në shqyrtim kërkesën ankimore të palës paditëse z. Lefter Maliqi. Pas zhvillimit të seancës dëgjimore dhe sqarimit të kërtimeve të palës ankuese, KAS me vendimin nr.136, datë 24.05.2023 ka vendosur që të pranojë dhe të marrë në shqyrtim kërkesën ankimore për ndryshimin e vendimit nr. 101, datë 16.06.2023 të KZAZ nr.64, Bashkia Kuçovë, Qarku Berat, “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Kuçovë”, si dhe për pavlefshmëri të zgjedhjeve në zonën zgjedhore. Ndërkohë për katër kërtime të kërkesës ankimore është vendosur rrëzimi për shkak të moskompetencës. Konkretisht këto kërtime janë “4. Konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit të KQZ ku është emëruar sekretari i KZAZ, Nr.64 Kuçovë, shtetasi Romeo Arizi. 5. Pavlefshmërinë e vendimit të KZAZ, Nr.64 Kuçovë, Qarku Berat, për shtyrjen e numërimit të votës, nga ora 11:00 deri në 12:30. 6. Pavlefshmërinë e pjeshme të fletës së votimit Kandidatët për Kryetar Bashkie për Bashkinë Kuçovë, në pikën ku është shënuar kandidati për Bashkinë Kuçovë Qarku Berat Kreshnik Hajdari. 7. Pavlefshmërinë e veprimit juridik, formularin e dekriminalizimit, në emër të Kreshnik Hajdarit dorëzuar pranë K.Q.Z referuar ligjit, nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Vendimi i mësipërm i KAS, është nënshkruar nga katër anëtarët e tij dhe për pasojë është i vlefshëm në kuptim të nenit 21, pika 3 e Kodit Zgjedhor. Në seancë gjyqësore u sqarua që pavarësisht kopjes së dërguar palës paditëse z. Lefter Maliqi që në faqen e fundit nuk shihet nënshkrim i një anëtarit të KAS, vendimi është nënshkruar nga të katër prej tyre në çdo faqe sipas vendimit të administruar (kopje e sjell nga KAS) në gjykim.

18. Kolegji Zgjedhor thekson se nenin 124 i Kodit Zgjedhor parashikon ndër të tjera se:

1. Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

2. Kundër vendimit të KZAZ-së për shpalljen e rezultatit për zgjedhjet e organeve të njësisive të qeverisjes vendore nën juridiksionin e saj, të marrë sipas nenit 122 të këtij Kodi, mund të paraqitet ankimi në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi.

...

4. Në çdo rast ankimi për pavlefshmëri, sipas nenit 160, dhe ankimi për ndryshimin e tabelës së rezultatit paraqitet në të njëjtën kërkesë ankimore, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni. Në kërkesë përcaktohen qendrat e votimit, për të cilat kërkohet ndryshimi i rezultatit apo pavlefshmëria.

...

6. Në shqyrtimin e kërkesave ankimore të paraqitura, KQZ-ja shqyrton të gjithë problematikën e tyre, përfshirë edhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi, pa u kufizuar në objektin e kërkimit të kërkesës ankimore të paraqitur nga subjekti zgjedhor.

19. Kolegji Zgjedhor vë në dukje se në bazë të nenit 124 të Kodit Zgjedhor, subjekti zgjedhor ndër të tjera ka të drejtë të bëjë ankim në KAS në lidhje me rezultatin e zgjedhjeve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore (pra dhe për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë) të shpallura nga KZAZ. Ky ankim bëhet për ndryshimin të tabelës së rezultatit dhe/ose për pavlefshmëri të zgjedhjeve sipas nenit 160 të Kodit Zgjedhor. Nëse ankimi bëhet për të dyja shkaqet, atëherë kërkesa duhet t'i përmbajë ato njëkohësisht. Përveç sa më sipër, neni 124 i Kodit Zgjedhor parashikon edhe parimin e ligjshmërisë dhe diskrecionit, ku duhet të mbështetet KQZ (KAS) në shqyrtimin e kërkesave ankimore, që është pikërisht shqyrtimi në tërësi të problematikës, pa u kufizuar në objektin e ankimit, duke përfshirë edhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi.

20. Më tej, kur paraqitet kërkesa ankimore, sipas nenit 124 të Kodit Zgjedhor, KAS në kuptim të nenit 129 të Kodit Zgjedhor kryen fillimisht verifikimin e formës dhe përmbajtjes së kërkesës. Konkretisht neni 129, pika 3 e Kodit Zgjedhor parashikon që KQZ-ja bën verifikimin paraprak të kërkesës ankimore dhe vendos: a) kalimin e kërkesës për shqyrtim; b) mospranimin e kërkesës për shkak të mungesës së elementeve të përcaktuara në nenin 130 të këtij Kodi; ose c) kthimin e kërkesës për plotësim të elementeve të formës, të përcaktuara në nenin 126 të këtij Kodi. Neni 130 i Kodit Zgjedhor parashikon se KQZ-ja merr vendim për pranimin ose mospranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon elementet e mëposhtme: a) kompetencën e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit; b) legjitimitimin e ankuesit; dhe c) respektimin e afateve ligjore për ankimin. Më tej në nenin 131 të Kodit Zgjedhor parashikohet ndër të tjera se Në vendimin e pranimit për shqyrtim të kërkesës ankimore, KQZ-ja duhet të përcaktojë datën dhe orën për

shqyrtimin e çështjes në seancë publike. Ndërsa neni 132 i Kodit Zgjedhor parashikon bashkimin nga KAS të shqyrtimit të kërkesave ankimore ndaj rezultatit të një zone zgjedhore, të paraqitura nga subjekte zgjedhor të ndryshëm, sipas nenit 124 të Kodit Zgjedhor.

21. Pra, sipas rregullimit të mësipërm ligjor, KAS ka të drejtë ndër të tjera që kërkesat ankimore të paraqitura sipas nenit 124 të Kodit Zgjedhor, t'i pranojë për shqyrtim duke caktuar seancën publike dëgjimore, ose të vendosi mospranimin e tyre; si dhe kërkesat ankimore për të njëjtën zonë zgjedhore, të pranuar për shqyrtim, t'i bashkojë dhe shqyrtojë së bashku. Kundër vendimit të mospranimit për shqyrtim të kërkesës ankimore mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, sipas nenit 145 të Kodit Zgjedhor, pasi ky vendim cenon interesat e subjekti zgjedhor që ka paraqitur ankesën.

22. Në rastin konkret, KAS me vendimin objekt gjykimi ka vendosur pjesërisht pranimin dhe kalimin për shqyrtim të kërtimeve në lidhje me ndryshimin të tabelës së rezultatit të zgjedhjeve dhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore të subjektit zgjedhor z. Lefter Maliqi, kandidat për kryetar bashkie të Bashkisë Kuçovë. Më tej ka vendosur bashkimin për shqyrtim të kësaj kërkesë ankimore me kërkesën ankimore të subjekti zgjedhor, koalicioni “Bashkë Fitojmë” (shih më lart pikën 11). Nga ana tjetër për kërkitet e tjera në kërkesën ankimore të subjektit zgjedhor z. Lefter Maliqi, kandidat për kryetar bashkie të Bashkisë Kuçovë, nuk ka vendosur mospranimin për shqyrtimin e tyre, por rrëzimin për moskompetencë (shih më lart pikën 17) në kundërshtim me nenin 129, pika 3, gërma “b” dhe 130 të Kodit Zgjedhor.

23. Nga pala e paditur KQZ, u pretendua se vendim-marrja e KAS për rrëzimin e kërtimeve është e ndërmjetme dhe argumentimi për të do pasqyrohet në vendimin përfundimtar dhe në këtë kuptim pala paditëse ka të drejtën e ankimit me vendimin përfundimtar. Nga ana tjetër nga KQZ u parashtrua se kërkitet e rrëzuara nuk merren në shqyrtim, pasi nuk janë kompetencë e KAS. Kolegji thekson këto pretendime të KQZ-së janë të pabazuara në parashikimin e mësipërm ligjor, pasi për mungesë kompetence KAS duhet të vendosë mospranimin e ankimit për shqyrtim, si dhe duhet të pasqyrojë arsyetimin në vendimin e mospranimit, pasi ky vendim cenon palën ankuese dhe për pasojë kjo e fundit ka të drejtë të paraqesë padi në Kolegjin Zgjedhor. Ky i fundit shqyrton vendim-marrjen e KAS në lidhje me mospranimin duke analizuar edhe arsyetimin e tij. Pra, vendim-marrja e KAS nuk mund të argumentohet nga përfaqësuesit e KQZ-së në gjykim, por duhet të arsyetohet nga trupa vendim-marrëse në vendim. Ndërkohë rezultoi që KAS në rastin konkret nuk ka marrë vendim për mospranim e kërtimeve 4-7 të kërkesës ankimore dhe madje as nuk ka arsyetuar vendimin e rrëzimit të këtyre kërtimeve (shih më lart pikën 17).

24. Sa më sipër vendimi nr. 136, datë 24.05.2023 i KAS në lidhje me pikën 2 të tij duhet të shfuqizohet, si i dhënë në kundërshtim me nenet 124, 129, 130 të Kodit Zgjedhor.

25. Në kushtet e mësipërme, kur KAS ka kaluar për shqyrtimin e kërkesës ankimore për ndryshimin e tabelës së rezultatit dhe për pavlefshmëri të zgjedhjeve në zonën zgjedhore, Kolegji vlerëson se kërkitet që janë rrëzuar për shkak të moskompetencës (që janë pikat 4-7 të kërkesës

ankimore), KAS ka detyrimin që t'i shqyrtojë në fazën ku është procesi administrativ dhe vetëm në kuadër të shkaqeve të pavlefshmërisë së zgjedhjeve në zonën zgjedhore sipas nenit 160 të Kodit Zgjedhor. Kjo referuar dhe sqarimit të bërë në gjykim nga pala paditëse që këto kërkime janë paraqitur në kuadër të shkaqeve për pavlefshmëri të zgjedhjeve dhe nuk janë kërkime që qëndrojnë më vete, si dhe referuar dhe parimit të parashikuar nga nenit 124 pikës 6 e Kodit Zgjedhor (shih më lart pikën 29) . Pra, KAS duhet të verifikojë sipas nenit 160 të Kodit Zgjedhor nëse çdo kërkim i mësipërm është shkak për shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve në një apo shumë qendra votimi. Pra nëse janë shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit, të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore.

26. Kolegji Zgjedhor vendos sa më sipër, me qëllim rregullimin e pasojave të një procesi administrativ që ka përfunduar me një vendim-marrje të KAS në kundërshtim me nenet 124, 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor, pasi KAS ka kaluar në fazën e shqyrtimit të kërkesës ankimore dhe shkaqet e mësipërme të pasqyruara në kërkimet 4-7 të ankimit, nuk i ka vlerësuar as si të pranueshme dhe as si të papranueshme, por i ka rrëzuar përmes një vendimi të paarsyetuar.

27. Kolegji Zgjedhor gjen me vend të ritheksojë se në raste të ngjashme KAS ka detyrimin sipas nenit 129 të Kodit Zgjedhor të vendosë pranimin ose jo të çdo kërkimi të kërkesës ankimore, duke argumentuar shkaqet në rastin e mospranimit, pasi pala e interesuar ka të drejtën e ankimit në këtë rast sipas nenit 145 të Kodit Zgjedhor.

28. Nga ana tjetër, Kolegji Zgjedhor e gjen pretendimin e palës paditëse që çështja të kthehet në KAS për t'u shprehur në lidhje me pranueshmërinë e kërtimeve 4-7 të ankimit, si një kërkim që gjykimi i tij nuk mund të vazhdojë, sakohë që vendosi që KAS duhet të shqyrtojë kërkimet 4-7 të kërkesës ankimore së bashku me pretendimet dhe shkaqet e tjera të ngritura në kërkesën ankimore në lidhje me pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Për pasojë në kuptim të nenit 299, gërma "c" të KPrC, Kolegji Zgjedhor vendos pushimin e këtij kërkimi të padisë.

29. Kolegji thekson se çështja objekt gjykimi merr zgjidhje bazuar në argumentet e mësipërme dhe çdo pretendim tjetër i palëve në lidhje me mosmarrëveshjen të parashtruar më lart në vendim, nuk çon në një përfundim tjetër të saj dhe për pasojë nuk analizohet më tej.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në nenin 158 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,unanimisht

### **VENDOSI:**

1. Pranimin e pjesshëm të padisë.
2. Shfuqizimin e pikës 2 të Vendimit nr.136, datë 24.05.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.
3. Detyrimin e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve të bëjë pjese të shqyrtimit, kërkimet e rrëzuara për shkak të mungesës së kompetencës të kërkesës ankimore nr.74, datë 22.05.2023, të ankuesit Lefter Maliqi, në kuadër të shkaqeve të pavlefshmërisë së zgjedhjeve.
4. Pushimin e gjykimit të pjesës tjetër të padisë.
5. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
6. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë më datë 07.06.2023.

**GJYQTAR**  
**Sokol IBI**

**GJYQTARE**  
**Edlira PETRI**

**GJYQTARE**  
**Blerona HASA**

**GJYQTARE**  
**Alma KOLGJOKA**

**GJYQTARE**  
**Manjola XHAXHO**